



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.123/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Afiete Sada dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Subjektit Politik Nisma për Kosovën (NISMA), për tërheqjen e ankesës së parashtruar ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur me 21.12.2016, mori këtë:

V E N D I M

Konstatohet e tërhequr ankesa Anr123/2016 e datës 19.12.2016, që ka të bëjë me Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të parashtruara në PZAP nga Subjekti Politik Nisma për Kosovën.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar nga subjekti politik NISMA një kërkesë për tërheqjen e ankesës të parashtruar në PZAP, Anr123/2016 e datës 19.12.2016, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në të cilën kërkohet që të tërhiqet nga shqyrtimi ankesa e lartpërmendur për shkak të pamundësisë për të siguruar provat ashtu siq është kërkuar në kërkesën për plotësim të ankesës nga PZAP-i Anr.128/2016 të datës 20.12.2016 nga subjekti politik në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqje e ankesës së sipërshtënuar, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohe pjesa që ka të bëjë me iniciativën në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 123/2016 më datën 21.12.2016

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani

